

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Shoqëria "ALBANIAN MOTOR COMPANY" Sh P K



VENDIM

/

ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE TË SHOQËRISË
"ALBANIAN MOTOR COMPANY" SH P K

Sot më datë 24 Dhjetor 2012 (dymijë e dymbëdhjetë), në Selinë e Shoqërisë "Albanian Motor Company" Sh.p.k., të ndodhur në adresën: Qendër Ford, Kashar, Tiranë, Shqipëri, me NIPT K41829010J, zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë "Albanian Motor Company" Sh.p.k..

Kjo mbledhje e asamblesë së përgjithshme e ortakëve të shoqërisë "Albanian Motor Company" Sh.p.k., është thirrur me kërkesën e të gjithë ortakëve të shoqërisë dhe verifikohet pjesëmarrja e ortakëve të shoqërisë, ku rezulton që marrin pjesë, duke qenë të pranishëm ortakët si më poshtë:

- **Ortaku: Shoqëria "Iner" Sh.p.k.**, që përfaqëson 75% të kapitalit të shoqërisë, e përfaqësuar nga përfaqësuesit e autorizuar të shoqërisë, **Z. Adrian Dulaku, Z. Artan Dulaku dhe Z. Genci Dulaku**, dhe
- **Ortaku: Dalewest Albania Limited**, që përfaqëson 25% të kapitalit të shoqërisë, e përfaqësuar nga përfaqësuesit e autorizuar të shoqërisë **Z. Christos LIASI**, i datëlindjes 05.02.1961 dhe **Z. Ken E LALO**, i datëlindjes 09.02.1958.

Administratori verifikoi identitetin dhe prezencën e përfaqësuesve të shoqërisë "Albanian Motor Company" Sh.p.k., që do të thotë se janë të pranishëm 100% (njëqind përqind) të pjesëve të kapitalit të shoqërisë "Albanian Motor Company" Sh.p.k., gjë që do të thotë se asambleja është thirrur rregullisht, në gjendje për të diskutuar dhe vendosur mbi:

PIKAT E RENDIT TË DITËS SI MË POSHTË :

1. Shqyrtimin e raportit për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Albanian Motor Company" Shpk, të hartuar nga studio "Filito Auditing" shpk, me Eksperte Kontabël e Autorizuar Zj. Tatiana Filto (Kotepano) me Nr. Liçense 67.
2. Miratimin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë "Albanian Motor Company" Shpk.
3. Të tjera dhe eventuale.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë "Albanian Motor Company" Sh.p.k., e mbledhur rregullisht për të vendosur me pjesëmarrjen e 100% të ortakëve të shoqërisë, të cilët janë vetë prezent, pasi

dëgjuan relatimin e Administratorit të Shoqërisë Z. Ilia Çili dhe shqyrtoi dokumentacionin përkatës, në përfundim të diskutimeve, në unanimitet të plotë,

V E N D O S I :

1. Të miratojë "Raportin për zmadhim kapitali", të datës 18 Shtator 2012, të hartuar nga studio "Filito Auditing" shpk, me Eksperte Kontabël e Autorizuar Zj. Tatiana Filto(Kotepano) me Nr.Liçense 67, e cila ka evidentuar zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Albanian Motor Company" Shpk.

2. Të miratojë zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Albanian Motor Company" shpk, me vlerën totale prej 67'160'000(gjashtëdhjetë e shtatë milion e njëqind e gjashtëdhjetë mijë)Lekë, i ndarë në 67'160'(gjashtëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) kuota, me vlerë nominale 1'000(njëmijë) Lekë për kuota.

3. Si rrjedhim i këtij zmadhimi, kapitali i shoqërisë "Albanian Motor Company" shpk, bëhet në vlerën totale prej 153'145'000(njëqind e pesëdhjetë e tremilion e njëqind e dyzet e pesëmijë)Lekë, të ndarë në 153'145(njëqind e pesëdhjetë e tremijë e njëqind e dyzet e pesë) kuota me vlerë nominale 1'000(njëmijë) Lekë për kuota.

4. Pas përfundimit të temave të rendit të ditës, duke mos patur gjë tjetër për të diskutuar, shoqëria e mësipërme nuk bën ndryshime të tjera, të cilat mbeten ashtu siç janë, drejtuesi shpall mbylljen e kësaj mbledhjeje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë "Albanian Motor Company" Sh.p.k..

5. Sa më sipër, ky vendim do të depozitohet për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, për t'u pasqyruar kufizimet përkatëse në përputhje me neni, 81 pika "ë", nenit 87, paragrafi 1, e vijues, të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe nenit 43 e vijues, të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Ortakët e Shoqërisë

"Albanian Motor Company" SH.P.K.

Shoqëria "INER" SH.P.K.

Përfaqësuar nga:

Z. Adrian Dulaku

Z. Artan Dulaku

Z. Genci Dulaku

Dalewest Albania Limited

Përfaqësuar nga:

Z. Christos LIASI

Z. Ken E LALO

